



Data: 06.07.2017

Ref.: 579/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

#### V E N D I M

- I. Pezullohet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
  - Mjekesi Sanitare, BSc, 180 ECTS, (vendimi nr. 641/15, datë 13/07/2015);
  - Infermieri, BSc, 180 ECTS, (vendimi nr. 641/15, datë 13/07/2015);
  - Biokimi Laboratorike, BSc, 180 ECTS, (vendimi nr. 641/15, datë 13/07/2015);
  - Farmaci Komunitare, BSc, 180 ECTS, (vendimi nr. 641/15, datë 13/07/2015);
  - Fizioterapi, BSc, 180 ECTS, (vendimi nr. 641/15, datë 13/07/2015);
  - Radiologji Diagnostike, MSc, 120 ECTS, (vendimi nr. , 820/15, datë 31/08/2015);
  - Stomatologji, Dr.Dent. 300 ECTS, (vendimi nr. , 820/15, datë 31/08/2015);
  - Infermieri, MSc, 120 ECTS, (vendimi nr. , 820/15, datë 31/08/2015).
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve në vitin akademik 2017/2018 në programet e studimit të cekura në pikën I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

Bazuar në kërkesën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) drejtuar të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) për dorëzimin e listave të stafit akademik për të gjitha programet ekzistuese, dhe pas verifikimit nga AKA te dokumentacionit te dorëzuar nga BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore “Rezonanca”,

u konstatua se programet e cekura në pikën I, të këtij vendimi nuk i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (UA për Akreditim). Sipas nenit 11, pika 3.2 e UA për Akreditim për secilin program të studimit duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc.

Bazuar ne kriteret të cilat i parashihen në UA për Akreditim, nenit 11, pika 3.2 dhe 3.3 e UA, janë trajtuar të gjitha dokumentet të cilat janë dorëzuar nga Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca", dhe si përfundim është konstatuar që asnjëri nga programet e cekura në pikat I, II, III dhe IV, të këtij vendimi nuk posedojnë nga tre Dr.sc. me dokumentacion te rregullt sipas kërkesave te AKA-së.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca", dhe ka konstatuar që programet e cekura në pikën I, të këtij vendimi nuk i përmbushin kriteret e cekura në UA për Akreditim, dhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Bazuar në UA për Akreditim, neni 28 , pika 2 dhe 3, AKA mund ta tërheq akreditimin ne rastet e caktuara. Sipas këtij neni, AKA mund ta tërheq akreditimin në rast se ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve të studimit në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Kjo këshill juridike jepet duke u bazuar nenin 157 (Dispozitat kalimtare) të Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr.05/L-031, datë 25 maj 2016) i cili ka hyrë në fuqi me 21 qershor 2017. Sipas këtij neni Procedurat administrative të filluara dhe të pa përfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

